



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE

Nr. 1577 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 1434 Prot.

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

LIDHUR NDËRMJET

*Palëve:*

**Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përfaqësuar nga Znj. Flora ÇABEJ (POGAÇE);**

**Dhe**

**Prokurorisë së Përgjithshme, përfaqësuar nga Znj. Ina Rama**

Të frymëzuar nga dëshira për të bashkëpunuar ndërmjet të dy autoriteteve për të respektuar të dhënat personale dhe garancitë për respektimin e këtyre të dhënave të parashikuara në legjislacionin në fuqi;

Me qëllim që të sigurohet përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit në gjyq nga ana e prokurorëve;

Të nxitur nga qëllimi për të shprehur vendosmërinë, tolerancën dhe solidaritetin e të dy institucioneve në kudër të respektimit të të dhënave personale;

Duke riafirmuar vendosmërinë e tyre për të kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në procesin e zbatimit të legjislacionit respektiv të dy institucioneve.

*Palët kanë rënë dakord për sa më poshtë:*

## **Neni 1**

### **Sfera e bashkëpunimit**

Prokuroria e Republikës së Shqipërisë angazhohet:

- Me ndihmën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të hartojë një rregullore të brendshme për mbrojtjen dhe për sigurinë e të dhënave personale;
- të përfshijë dispozita në lidhje me të dhënat personale në kodin e etikës së Prokurorisë;
- të caktojë një person kontakti për të dhënat personale. Personi i kontaktit do të mbajë marrëdhënie të vazhdueshme bashkëpunimi me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me qëllim ndarjen e informacionit mes dy institucioneve dhe sigurimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm;
- të krijojë mundësinë praktike që të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe punonjësit e tjerë të Prokurorisë së Shqipërisë, të trajnohen në lidhje me të dhënat personale dhe respektimin e tyre gjatë punës së përditshme;
- në bashkëpunimin e vazhdueshëm për ndjekjen e procedurave në të gjitha rastet e transferimit ndërkombëtar të të dhënave në shtetet me nivel të pamjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave;
- që sfera e bashkëpunimit me Komisionerin për mbrojtjen e të dhënave personale të shtrihet edhe në organet e prokurorisë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale angazhohet:

- të ofrojë asistencën dhe ekspertizën e tij për hartimin e rregullores së brendshme të Prokurorisë për mbrojtjen e të dhënave personale;
- të ofrojë asistencën dhe ekspertizën e tij për hartimin e dispozitave të kodit të etikës së Prokurorisë për mbrojtjen e të dhënave personale;
- të mbështesë Pikën e Kontaktit të Prokurorisë gjatë bashkëpunimit reciprok, duke i ofruar atij gjithë ndihmën dhe asistencën e nevojshme për të siguruar që marrëdhënia mes dy institucioneve të jetë e vazhdueshme;
- të mundësojë trajnimin e të gjithë prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Shqipërisë, sipas mundësive praktike të krijuara nga Prokuroria.

Të dyja palët angazhohen:

- të marrin pjesë në grupet e punës për të dhënë mendime në hartimin e udhëzimeve në veprimtarinë e sektorëve me interes të përbashkët, në veçanti në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kohën e mbajtjes së tyre;
- të nxisin mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok;

## **Neni 2**

### **Komunikimi i palëve**

- Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi kryhet në formë shkresore.

- Palët caktojnë një person kontakti që është përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
- Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me palën tjetër.

### **Neni 3 Shtesat dhe ndryshimet**

Palët mund të bëjnë shtesat ose ndryshimet e nevojshme të kësaj marrëveshjeje në çdo kohë, bazuar në pëlqimin e ndërsjellët të paraqitur me shkrim.

### **Neni 4 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

### **Neni 5 Përfundimi i Marrëveshjes**

Marrëveshja lidhet për një periudhe të pacaktuar kohe.

Marrëveshja mund të përfundojë nga secila Palë 1 (një) muaj pas dërgimit të njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.

### **Neni 6 Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.

Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen tek Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe dy në Prokurorinë e Republikës së Shqipërisë.

Nënshkruar në Tiranë, më 18/05 / 2012.

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE**



**Flora Çabej (Pogaçe)**

**PROKURORI  
I PËRGJITHSHËM**



**Ina Rama**